



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

RELACION

PËR NJË NDYSHIM NË VENDIMIN NR.60 DATË 18.12.2019 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAT DHE VENDORE NË BASHKINË BERAT”

Të nderuar këshilltar !

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr.60 datë 18.12.2019 ka miratuar paketën fiskale në të cilën janë përcaktuar taksat dhe tarifatat për subjektet që ushtojnë aktivitet tregtar në Bashkinë Berat.

Duke qënë të vëmendshem ndaj kërkesave të biznesit që kanë të bëjnë me implementimin sa më korrekt të paketës fiskale, kërkesa këto që i shërbejnë përmirësimit të saj në vijimësi, na rezultojnë se një mjet i transportit të mallarave taksohet dy herë, të ndara këto, në koka tërheqëse dhe në rimorkio dhe gjysëm rimorkio.

- Mbështetur në parimin se dy mjetet kokë tërheqëse dhe rimorkio/gjysëmrimorkio nuk funksionojnë të ndara në shërbim të biznesit dhe taksimi nuk mund të jetë për secilën pjesë më vete, krijon taksim të dyfishtë për biznesin.

Në këto kushte e shikojmë të domosdoshme korrigjimin me efekt favorizues dhe të drejtë në paketën fiskale për këtë kategori biznesi.

Nisur nga fakti se efekti financiar i këtij ndryshimi në buxhetin e Bashkisë Berat është i një vlere relativisht të vogël (486,000 lekë), por me një ndikim të madh për lehtësimin që i krijojmë biznesit i cili për të njëjtën veprimtari dhe të njëjtin mjet tarifohet dy herë. propozojmë:

Në VKB nr.60 datë 18.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifatat dhe vendore në Bashkinë Berat”, i ndryshuar KREU II, seksioni “Sqarime”, shtohet pika si më poshtë:

Për subjektet që kanë në fushën e veprimtarisë transportin, për mjetet që në QKB i kanë të regjistruara në adresa të ndryshme, koka tërheqëse dhe rimorkio /gjysëmrimorkiot do të paguajnë tarifatat vetëm për kokat tërheqëse dhe jo për rimorkiot/gjysëmrimorkiot në adresat e regjistruara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

Efekti financiar nga ky ndryshim është në vlerën 486,000 lekë.

DREJTOR I TAKSAVE DHE I TARIFAVE

~~Sokol Toska~~